




ORIKUM
ORTOFOTO E PËRFTUAR NGA IMAZHET SATELITORE


Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar

Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare me teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360°, ASIG ka realizuar fotografimin dhe publikimin në Gjeoportalin Kombëtar të rrugëve urbane të qytetit të Krujës. Gjatësia e aksit të mbuluar me fotografi 360° është 58 km. Ky informacion vizual i detajuar shërben si mjet mbështetës për planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.



Rrugë Urbane - Qyteti i Krujës

Zgjerimi i Hartës Bazë - Qyteti i Kavajës



Qyteti i Kavajës

ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën "Harta Bazë", si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale të qytetit të Kavajës. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rievimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rievuar prej 20 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rievime fotogrametrike 3D arrin në 180.


Publikohet informacion gjeohapësinor për temën “Parcelat Kadastrale”

ASIG, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresat gjeohapësinore për Parcelat Kadastrale dhe Ndërtesat Kadastrale, në kuadër të zbatimit të marrëveshjes ndërinstitucionale për shkëmbimin dhe përditësimin e të dhënave.

Përveç parcelave të zakonshme, shtresat përfshijnë edhe parcelat e pyjeve dhe kullotave në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, duke rritur saktësinë, përditësimin dhe qasjen në informacionin kadastral.

Publikimi është realizuar në përputhje me VKM nr. 321, datë 27.04.2016, për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor – Tema: Parcelat Kadastrale”.

Publikohet në ArcGIS Online Mbulesa e Tokës - Bashkia Devoll



ASIG ka publikuar në ArcGIS Online, WebMap-in me shtresën e Mbulesës së Tokës për Bashkinë Devoll, e cila shërben për planifikimin urban dhe zhvillimin e territorit, duke ofruar një pamje të detajuar të strukturës së mbulimit të tokës. Ky WebMap ofron të dhëna të sakta dhe të përditësuara mbi përdorimin e tokës, duke ndihmuar institucionet publike dhe ekspertët e mjedisit në menaxhimin efikas të burimeve natyrore dhe hartimin e politikave territoriale të bazuara në analiza të sakta dhe të standardizuara.



Workshop mbi Kornizën Referuese Gjeodezike dhe Modelimin e Gjeoidit në Shqipëri

Më 17 prill 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë (ASHSH), u zhvillua workshopi shkencor “Korniza Referuese Gjeodezike dhe Modelimi i Gjeoidit në Republikën e Shqipërisë”, organizuar nga ASIG në bashkëpunim me ASHS. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të ASIG, specialistë të IGEO dhe partnerë nga Universiteti “Aristoteli” i Selanikut, të cilët prezantuan ndërtimin e Kornizës Moderne Gjeodezike, rrjetin ALBCORS me teknologji GNSS dhe modelin e parë gravimetrik-hybrid të gjeoidit shqiptar. Workshopi u cilësua si një arritje e rëndësishme për gjeodezinë shqiptare, duke vlerësuar kontributin e ASIG në ndërtimin e infrastrukturës moderne të referimit dhe në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin hapësinor dhe shkencat e tokës.



ASIG merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Rrjetit Evropian të Hapësirës



Më 10–11 prill 2025, ASIG mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Rrjetit Evropian të Hapësirës, të mbajtur në Venecia, të Italisë, si pjesë e rrjetit Copernicus Relay. Institucioni u përfaqësua nga Z. Dritan Prifti, Drejtor i Drejtorisë së Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing.

Gjatë aktivitetit u prezantuan arritjet dhe sfidat e institucioneve pjesëmarrëse, u diskutua për zhvillimin e rrjeteve hapësinore në BE, si dhe për përdorimin e të dhënave hapësinore në funksion të qëndrueshmërisë mjedisore, sigurisë hapësinore, ndërtimit të kapaciteteve dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

BOTA E GJEONFORMACIONIT

OME2 dhe Nazka Mapps: Kufijtë administrativë evropianë në dispozicion përmes një platforme të hapur gjeohapësinore

Platforma boundaries-api.io, e zhvilluar nga kompania belge Nazka Mapps, tashmë është publike falë të dhënave të hapura të projektit Open Maps For Europe 2 (OME2), bashkë financuar nga Bashkimi Evropian. Kjo ndërfaqe ofron qasje të drejtpërdrejtë në kufijtë administrativë të harmonizuar dhe të përditësuar në gjithë Evropën. E mbështetur në datasetet zyrtare të EuroGlobalMap dhe EuroRegionalMap, të mbledhura nga agjencitë kombëtare gjeografike, platforma ndihmon zhvilluesit të shmangin përpunimin, harmonizimin dhe mirëmbajtjen individuale të të dhënave.

Transporti ndërmodal mbështetur nga teknologjitë hapësinore të Bashkimit Evropian

Të dhënat nga sistemet hapësinore evropiane Galileo dhe Shërbimi Evropian për Navigimin Gjeostacionar (European Geostationary Navigation Overlay Service - EGNOS), së bashku me programin e Vëzhgimit të Tokës Copernicus (Copernicus Earth Observation Programme), po kontribuojnë në ndërtimin e një sistemi transporti të integruar, të qëndrueshëm dhe inteligjent në të gjithë Evropën. Projekti JULIA, i mbështetur nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Programin Hapësinor (European Union Agency for the Space Programme - EUSPA), synon të ndërlihdë në kohë reale mjete të ndryshme transporti përmes një aplikacioni inovativ që ofron informacion të menjëhershëm, planifikim ndërmodal të udhëtimit dhe sistem të unifikuar pagese. Kjo nismë forcon lëvizshmërinë e qytetarëve, redukton kohët e pritjes dhe nxit përdorimin e mjeteve të gjelbra, duke kontribuar në objektivat mjedisore dhe sociale të qyteteve të së ardhmes.

AKTIVITETE NË VIJIM

QGIS User Conference 2025

Konferenca vjetore e QGIS do të mbahet më 2-3 qershor 2025 në Norrköping, Suedi, duke ofruar një platformë për ekspertë dhe profesionistë të fushës së gjeoinformacionit. Ky aktivitet ka për qëllim prezantimin e zhvillimeve më të fundit dhe shkëmbimin e njohurive mbi aplikimet inovative të QGIS në analizën dhe menaxhimin e të dhënave gjeohapësinore.

2 - 3 Qershor 2025

www.asig.gov.al

AGILE 2025

Shoqata e Laboratorëve të Informacionit Gjeografik në Evropë (AGILE) organizon nga 10–13 qershor 2025, në Dresden, të Gjermanisë, konferencën me temë "Shkenca e Gjeoinformacionit përballë sfidave globale". Aktiviteti do të mbledhë studiues dhe profesionistë nga Evropa dhe më gjerë për të prezantuar kërkime shkencore dhe zgjidhje inovative në fushën e gjeoinformacionit dhe vendimmarrjes së bazuar në të dhëna hapësinore.

10 -13 Qershor 2025

FOSS4G Europe 2025

Konferenca Evropiane FOSS4G do të zhvillohet nga 14–20 korrik 2025 në Mostar, të Bosnjë-Hercegovinës. Aktiviteti do të mbledhë profesionistë, studiues dhe studentë nga fusha e gjeoinformacionit për të ndarë njohuri, përvoja dhe zgjidhje inovative në përdorimin e teknologjive të hapura për hartografi, analiza hapësinore dhe planifikim.

14 -20 Korrik 2025

www.geoportal.asig.gov.al